



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER PERIAN B. BODINAKU  
ADRESA Ç. TOPULLI  
TEL: 674010104

# KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 21482

Nr. koleksioni: 8796

Tirane më 15/11/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2023052641009934110



1912





A2023052641009934110

## KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI

Sot, më datë 15.11.2023, para meje Notere PERIAN B. BODINAKU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Ç. TOPULLI, u paraqit personalisht:

### DHURUES:

Glendi Abdi, atësia Ali, amësia Fiqirete, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Jordan Misja; Nd. 0; Njësia Administrative Nr. 9; Njesia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 28/08/1972, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034467421 dhe nr. personal H20828180L, ne cilesine e ortakut te vetem te Shoqerise " TDT & PARTNERS" shpk, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L61814005P, me adresë Njesia Bashkiake Nr 2, Rruga Deshmoret E Kombit, Kullat Binjake Nr 1, Kati 12, Ap 12/1, zoterues i 100 % te kuotave te kapitalit te shoqerise.

*(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Dhuruesi")*

### PRANUES I DHURIMIT:

DAJLAN AVDIA, atësia Ali, shtetas Gjerman, lindur në Tirane lindur më 20/06/1968,, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. C4X6TR3VV dhe nr. personal C4X6TR3VV, .

*(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Përfituesi i dhurimit")*

### Rrethanat e hartimit të aktit noterial:

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate për dhurimin e kuotave të kapitalit. Unë noteri/ja, pasi verifikova identitetin e tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartoj këtë kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

### Deklarime Paraprake

1-Shoqeria "Tdt & Partners" sh.p.k, eshte regjistruar si person juridik ne Qendren Kombetare te Regjistrimit te Biznesit me Nuis (NIPT) -L61814005P, ne date 14/06/2016, me kapital me vlere 142,917,737 leke (njqinde e dyzete e dy million e nenteqinde e shtatembedhjete mije e shtateqinde e tridhjete e shtate lek) dhe ka status "Aktiv".

2- Dhuruesi eshte zoterues i 1 kuote të cilat perbejne 100 % te kapitalit te kesaj shoqerije.

### NENI 1 Objekti;

1.1 Objekt i kesaj kontrate eshte kalimi nga dhuruesi te pranuesi i dhurimit të ½ e kuotes e cila eshte 50 % e barazvlefshme me 71,458,868.5 leke (shtatedhjete e nje million e peseqinde e tetedhjete mije e teteqinde e gjashtedhjete e tete pike pese) leke te kapitalit të shoqerise, pa kundershperblim dhe pa kusht.

1.2 Zhveshja e dhuruesit nga te drejtat dhe detyrimet qe buronin nga qenia pronar 100%, e barazvlefshme me 142,917,737 leke (njqinde e dyzete e dy million e nenteqinde e shtatembedhjete mije e shtateqinde e tridhjete e shtate lek) te kapitalit te shoqerisë "Tdt & Partners" sh.p.k., ne 50% te kapitalit, objekt i dhurimit, nga momenti i nenshkrimit te kesaj kontrate.

**NENI 2**  
**Kalimi i pronësisë;**



A20230526410093400

2.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate realizohet kalimi i ½ kuotes dhe 50 % te pjeseve te kapitalit te shoqerise "Tdt & Partners" sh.p.k., nga dhuruesi te pranuesi i dhurimit dhe dhuruesi mbetet me 50% te kapitalit te shoqerise "Tdt & Partners" shpk.

2.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate pranuesi i dhurimit behet zotërues i ½ kuote dhe 50 % te pjeseve te kapitalit te shoqerise "Tdt & Partners" sh.p.k., duke marre persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe burojne nga qenia pronar i 50 % te pjeseve te kapitalit te shoqerise "Tdt & Partners" sh.p.k., nga momenti i nënshkrimit te kësaj kontrate.

**NENI 3**  
**Deklarime te paleve;**

3.1 Dhuruesi deklaron dhe garanton pranuesin e dhurimit se, pjeset e kapitalit te shoqerise, që i transferohen pranuesit te dhurimit, pa asnje kusht dhe kundershperblim, jane te lira nga çdo barre apo rendese tjetër, dhe menjehere lirisht të transferueshme te te tretet dhe mbi to nuk ka asnjë të drejte juridike ndaj te tretëve pervec pranuesit te dhurimit.

3.2 Pranuesi i dhurimit, deklaron se e njeh gjendjen e shoqerise, njeh te gjitha detyrimet qe ka dhuruesi ndaj shtetit (tatime, bashki, dogana etj....) dhe mer persiper shlyerjen e tyre , te gjitha detyrimet qe ka apo mund te dalin ndaj te treteve para dates se nënshkrimit te ketij akti dhurimi dhe pas kësaj kontrate duke perfshire dhe organeve shteterore, idivide apo institucione te cilat nuk jane permendur ne kete kontrate dhurimi. Pranuesi i dhurimit e pranon transferimin nëpermjet dhurimit ne favor te tij, duke marre përsipër të drejtat dhe detyrimet që do te burojne nga qenia pronar mbi kete pjese te kapitalit, te lindura qe nga momenti i regjistrimit te shoqerise "Tdt & Partners" sh.p.k, si person juridik ne Qendren Kombetare te Regjistrimit te Biznesit.

**NENI 4**  
**Data efektive e kontrates;**

4.1 Kjo kontratë është e përvokueshme, e pakthyeshme, efektive, e detyrueshme per palet dhe trashëgimtaret e tyre, qe nga data e nënshkrimit te saj.

**NENI 5**  
**Zgjidhja e Kontrates;**

5.1 Asnje nga palet nuk mund të zgjidhe në menyre te nje anshme këtë kontrate.

**NENI 6**

Trajtimi i kontratës, aktet bashkelidhur;

6.1 Kontrata u hartua në 4 (kater) kopje të barazvlefshme, ne gjuhen shqipe.

6.2 Kjo kontrate zevendeson çfaredo lloj marrëveshje, kontrate ose çfaredo lloj dokumenti tjetër dhe është e vetmja kontrate detyruese per palet ne lidhje me objektin e dhurimit.

**NENI 7**  
**Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni;**

7.1 Kjo kontratë është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe konkretisht të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.



A2023052641009934110

7.2 Të gjitha mosmarreveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate, nëse vetë palet me ndihmë juridike vazhdojnë të mos t'i kuptojnë e zbatojnë, si dhe në rast se vetë palet nuk gjejnë mirekuptim, mosmarreveshjet lihen objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### Dispozitat Përfundimtare

Kontrata e kalimit të të drejtave, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Bashkëlidhur gjendet dokumentacioni i mëposhtëm:

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

#### DHURUES

Glendi Abdi

ne cilesine e ortakut te vetem te

Shoqërisë "TDT & PARTNERS" shpk,



#### PRANUES DHURIMI

DAJLAN AVDIA

NOTERE

PERIAN B. BODINAKU





## REZULTATET E KERKIMIT

Numri i Rezultatit të kerkimit: D-20231115093337339  
Data e Rezultatit të Kerkimit: 15.11.2023  
Ora e Rezultatit të Kerkimit: 09:33:37  
**Lloji i Kerkimit:** Emri i Personit Juridik  
Numri i Dokumentit: D-400-628-12451

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0

TDT & PARTNERS SH.P.K.

Fundi i Rezultatit të Kerkimit

Fundi i Dokumentit



SUBJEKTI KERKUES:

Emertimi  
PERIAN BUJAR BODINAKU P.F.

*Ada Qoqja*

TE DHENAT E PERDORUESIT:

Emri dhe Mbiemri  
ADA QOQJA







## REZULTATET E KERKIMIT

Numri i Rezultatit të kerkimit: D-20231115093337339  
Data e Rezultatit të Kerkimit: 15.11.2023  
Ora e Rezultatit të Kerkimit: 09:33:37  
**Lloji i Kerkimit:** Emri i Personit Fizik  
Numri i Dokumentit: D-400-628-12451

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0

GLENDI ALI ABDI

Fundi i Rezultatit të Kerkimit

Fundi i Dokumentit



*Ada Qogja*



NIPT: L61814005P

Tiranë, më 13/11/2023

Adresa: Bulevardi "Dëshmoret e Kombit"

Kullat Binjake nr 1, kati 12, ap 38

Tiranë

## VENDIM

### I ORTAKUT TE VETËM TE SHOQËRISË

Sot me datë 13/11/2023 ora 11:00 u mbledh Asamblea e përgjithshme e shoqërisë Tdt & Partners SHPK ne selin e saj me adrese: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla nr.1, Kati 12, Apartamenti 38, Tiranë, Shqipëri.

I pranishëm ne këtë mbledhje është ortaku i vetëm i Shoqërisë, **Z.Glendi Abdi**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 28/08/1972, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr personal H20828180L ,zotërues i 100% te kapitalit.

Mbledhja u hap nga administratori dhe pasi verifikon kuorumin dhe shpreh vullnetin e Ortakut për te vendosur mbi Rendin e Ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për mbledhje, e deklaroi Asamblesë e Përgjithshme, të mbledhur rregullisht, në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit Nr. 9901/2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", dhe që mund të marrë vendime të vlefshme lidhur me Rendin e Ditës si më poshtë vijon:

#### Rendi i ditës

Dhurimin e ½ te kuotaave te shoqerise Z.Dajlan Avdia shtetas Gjerman, lindur në Tiranë, më 20/06/1968, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportes me nr personal C4X6TR3VV.

#### Deklaron

Mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme të Shoqërisë (në vijim referuar si "Asambleja") të mbledhur rregullisht dhe te aftë për të diskutuar e vendosur ne mënyre të vlefshme mbi Rendin e Ditës.

#### Vendosi:

- 1-Miratimin e dhurimit te ½ te kuotave te shoqerise Z.Dajlan Avdia.
  - 2-Nje kopje e dhurimit te mbahet ne regjistrat e shoqerise dhe nje kopje tjeter ti bashkëngjitet kontrates se dhurimit,
- Vendimi mbyllet me rendin Nr 2.

### ORTAKU I VETEM I

Shoqërisë TDT & PARTNERS SHPK

Z. Glendi Abdi

